



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT

Lënda: Gjeografi e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

• **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	B	B	A	A	B	B	B	C	A

• **Pyetjet me zhvillim**

Pyetja 11

2 pikë

- B- Gjatësia e valës
- C- Baza e valës

2 pikë

Nëse përcakton dy nga elementet e valës.

OSE

1 pikë

Nëse përcakton një nga elementet e valës.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë****Përgjigje e plotë për kërkesën a: 2 pikë**

- a) Gjatë ditës, shkëmbinjtë ngrohen dhe bymehen, kurse natën, duke u ulur temperaturat, tkurren. Përsëritja e vazhdueshme e këtyre proceseve (bymim, tkurje) prish kompaktësinë e shkëmbinjve duke i copëtuar ata.

Përgjigje e pjesshme për kërkesën a: 1 pikë

Tjetërsimi fizik për shkak të temperaturave ndodh si pasojë e ndryshimeve të mëdha të temperaturave gjatë 24 orëve.

- b) Mbizotëron më tepër në zonat e thata e të nxehta;

OSE

Në shkretëtira;

OSE

Në gjysmëshkretëtira.

3 pikë Nëse bën shpjegimin e plotë për kërkesën a dhe përcakton saktë kërkesën b.

OSE

2 pikë Nëse bën shpjegim të pjesshëm për kërkesën a dhe përcakton saktë kërkesën b.

1 pikë Nëse bën shpjegim të pjesshëm për kërkesën a.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënës-i/ja nuk fiton pikë nëse jep përgjigje të saktë për kërkesën b, pa shpjeguar kërkesën a.

Pyetja 13 **3 pikë**

- Erozioni **OSE** degradimi **OSE** dezertifikimi i tokave/shkretërizimi i tokave.
- Sasi të mëdha të dyoksidit të karbonit.
- Humbja e habitatit dhe biodiversitetit etj.

3 pikë Nëse përcakton tri nga pasojat.

OSE

2 pikë Nëse përcakton dy nga pasojat.

1 pikë Nëse përcakton një nga pasojat.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **4 pikë**

Veprimtaria karstike ndodh në malësinë e Gollobordës.

Veprimtaria erozive në malësinë e Çermenikës.

Karsti ndodh në Gollobordë për shkak të përbërjes nga shkëmbinj gëlqerorë të tretshëm nga uji, ndërsa në malësinë e Çermenikës ndodh procesi eroziv për shkak të përbërjes nga shkëmbinj të paqëndrueshëm terrigjenë.

- 4 pikë** Nëse shkruan proceset që ndodhin në secilën nga malësitë dhe arsyet.
- OSE**
- 3 pikë** Nëse shkruan proceset që ndodhin në secilën nga malësitë dhe një nga arsyet.
- 2 pikë** Nëse shkruan proceset që ndodhin në secilën nga malësitë.
- 1 pikë** Nëse shkruan proceset që ndodh në një nga malësitë.
- 0 pikë** Nëse për arsyen shkruan se përbëhen nga formacione shkëmbore të ndryshme **OSE** përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 15 **3 pikë**

- a) Forcat e jashtme
b)

Faktorët e brendshëm:

- Lëvizjet orogjenike/malformuese/ lëvizjet shkëputëse/lëvizjet rudhosëse;
- Lëvizjet e ngadalta shekullore/epirogjenike/luhatëse;
- Tërmetet/lëvizjet sizmike;
- Vullkanet.

Faktorët e jashtëm:

- Ujërat sipërfaqësore/nëntokësore;
- Bora/ngricat/akujt;
- Proceset karstike;
- Veprimtaria e erës, gjallesave etj.

- 3 pikë** Nëse shkruan “forcat e jashtme” për kërkesën a dhe përcakton një nga faktorët e brendshëm dhe një nga faktorët e jashtëm.

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan “forcat e jashtme” për kërkesën a dhe përcakton një nga faktorët e brendshëm **OSE** një nga faktorët e jashtëm.
- 1 pikë** Nëse shkruan “forcat e jashtme” për kërkesën a **OSE** përcakton një nga faktorët e brendshëm **OSE** një nga faktorët e jashtëm.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 16 **3 pikë**

Për krahinat gjeografike ndarja bëhet duke u bazuar vetëm në komponentët e mjedisit gjeografik, ndërsa rajonet gjeografike i trajtojnë në unitet dhe bashkëveprim dukuritë gjeografike të mjedisit natyror, zhvillimit ekonomik, human etj.

Shqipëria ndahet në 4 rajone gjeografike, ndërsa Kosova në 2 rajone gjeografike.

- 3 pikë** Nëse bën saktë dallimin midis krahinave dhe rajoneve gjeografike dhe përcakton saktë numrin e rajoneve të Shqipërisë dhe Kosovës;
- OSE**
- 2 pikë** Nëse bën saktë dallimin midis krahinave dhe rajoneve gjeografike **DHE** përcakton saktë numrin e rajoneve të Shqipërisë **OSE** të Kosovës;
- 1 pikë** Nëse bën saktë dallimin midis krahinave dhe rajoneve gjeografike **OSE** përcakton saktë numrin e rajoneve të Shqipërisë **OSE** të Kosovës;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

3 pikë

Bregdeti Adriatik	Bregdeti Jon
Bregdet i tipit të ulët.	Bregdet i tipit të lartë/shkëmbor.
Bregdet i tipit të grumbullimit.	Bregdet i tipit gërryes.
Përgjithësisht rritet sipërfaqja tokësore në kurriz të asaj detare.	Përgjithësisht rritet sipërfaqja detare në kurriz të asaj tokësore.
Mbizotërojnë plazhet ranore.	Mbizotërojnë plazhet zallore.
Formohen deltat, lagunat, ligatina etj.	Formohen falezat, harqet, shpellat etj.

- 3 pikë** Nëse shkruan tri nga ndryshimet për të dy tipet e bregdetit.
- OSE**
- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga ndryshimet për të dy tipet e bregdetit.
- 1 pikë** Nëse shkruan një nga ndryshimet për të dy tipet e bregdetit.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënës-i/ja nuk fiton pikë nëse jep përgjigje vetëm për një nga bregdetet.

Pyetja 18

3 pikë

- Deri në përfundim të Luftën II Botërore kanë ndikuar më shumë faktorët natyrorë: klima e ngrohtë/cilësia e mirë e tokës/burimet ujore etj.
- Ne periudhën 1945 – 1990 ndikuan faktorët politikë, ku shteti kontrollonte lëvizjet, faktorët ekonomikë (industrializimi i vendit), shoqërorë etj.
- Pas viteve 1990 me ndryshimet politike që ndodhën, faktori kryesor ishte ai ekonomik, ku njerëzit lëvizën për një jetesë më të mirë, për mundësi më të mëdha punësimi, arsimimi etj.

- 3 pikë** Nëse shpjegon faktorët që kanë ndikuar në secilën nga periudhat.
- OSE**
- 2 pikë** Nëse shpjegon faktorët që kanë ndikuar në dy nga periudhat.
- 1 pikë** Nëse shpjegon faktorët që kanë ndikuar në një nga periudhat.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19

3 pikë

Në vitin 1950 përqindja e popullsisë 0-14 vjeç ishte 35.4%, ndërkohë që në vitin 2007 shkon 13.5% dhe situata do të përkeqësohet akoma dhe më shumë në 2050 ku kjo përqindje do të arrijë 8.6%.

- Grupmosha në moshën e punës, në vitin 1950 ishte 59.6%, në vitin 2007 arriti në 65% dhe në vitin 2050 do të shkojë në 51.8%.
- Grupmosha mbi 65 vjeç në vitin 1950 ishte vetëm 4.9%, në vitin 2007 arrit në 21.5%, ndërkohë që parashikimet janë që në vitin 2050 kjo grupmoshë të arrijë në 39.6%.
- Trendi i kësaj piramide të popullsisë është që të zvogëlohet shumë grupmosha 0-14 vjeç, si pasojë e nivelit të ulët të lindjeve dhe të rritet shumë përqindja e grupmoshës së tretë në vitin 2050.
- Jetëgjatësia e femrave është më e madhe se e meshkujve si në vitin 2007 ashtu edhe për vitin 2050.

3 pikë Nëse nxjerr tre konkluzionet.

OSE

2 pikë Nëse nxjerr dy konkluzione.

1 pikë Nëse nxjerr një konkluzion.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20

3 pikë

3 pikë Nëse ndërton saktë profilin.

2 pikë Nëse ndërton pingulet dhe një nga pjesët e profilit.

1 pikë Nëse ndërton një nga pjesët e profilit **OSE** ndërton vetëm pingulet (projeksionet).

0 pikë Nëse e ndërton profilin gabim ose nuk e ndërton fare.

